



KPPP.nr. 612/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Kamenicës – Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, kundër debitorit V...sh.p.k, njësia nr. ..., me seli në Kamenicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.425/2020 të datës 18.11.2020, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 07.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET prapësimi i debitorit V...sh.p.k, njësia nr...., me seli në Kamenicë, ANULOHET urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.425/2020 të datës 18.11.2020, të lëshuar nga përmbartuesi Privat Kushtrim Musa nga Gjilani.

II.PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e kreditorit Komuna e Kamenicës – Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, ndaj debitorit V...sh.p.k, njësia nr..., me seli në Kamenicë, sipas urdhrit përmbartimor P.nr.425/2020 të datës 18.11.2020 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa në Gjilan.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Kamenicës – Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor – vendimit me nr. 8191 të dt. 06.04.2020 të Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat – Sektori i Inspektoratit, me të cilin ka obliguar debitorin që të paguaj ndëshkimin në shumë prej 1000 euro, me kamatë ligjore nga dita e dorëzimit të këtij urdhri për përmbartim të përmbartuesit privat, deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet procedurale. Realizimi i përmbartimit të bëhet ashtu që të urdhërohet bankat dhe institucionet tjera financiare, që fillimisht ti bllokojnë llogaritë bankare të debitorit dhe që nga llogaria e debitorit, në llogarinë

e kreditorit ti bartin mjetet monetare në emër të shumës së borxhit kryesor, shpenzimet procedurale dhe ato të përfaqësimit në procedurë përmbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim ka theksuar se e kundërshton në tërësi propozimin e kreditorit, pasi që për rastin për të cilën është shqiptuar gjoha në fjalë, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar të drejtën e ankesës në institucionin përkatës e cila është protokolluar me nr. 1728 të dt. 10.04.2020, për të cilën debitori nuk ka marr asnjë përgjigje në ankesë, andaj nuk qëndron deklarimi i kreditorit se debitori nuk ka bërë ankesë ndaj vendimit në fjale. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata vlerëson se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambient dhe Inspektorat, me të cilin Sektori i Inspektoratit debitorit i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 1000 euro, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Pas analizimit dhe vlerësimit të urdhrin për përmbarim dhe shkresave të lëndës, gjykata gjen se urdhri për përmbarim, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Musa, është lejuar mbi bazën e një dokumenti – akti administrativ cili nuk ka tipare të dokumentit përmbarimor, respektivisht nuk është i përshtatshëm për përmbarim, konform Nenit 24 dhe 36 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, një vendim i tillë i inspektoratit, nuk i përmbush tiparet e përmbarueshëmërisë konform Nenit 27 të LPP-së dhe nuk mund të jetë i përmbarueshëm sipas Nenit 24 par. 3 të LPP-së.

Me dispozitën e Nenit 24 par.3 të LPP-së, është paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së parashihet se *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes”*.

Ndërsa, me nenin 36 të LPP –së, është paraparë se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri.”*

Gjykata, duke vlerësuar urdhrin për përmbarrim – dokumentin përmbarrimor, gjeti se propozimi për përmbarrim bazohet mbi vendimin e Sektorit të Inspektoratit, i cili nuk i plotëson kushtet për lejueshmërinë e përmbarrimit. Vendimi administrativ në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk përmban klauzolën e përmbarrueshmërisë. Andaj, gjykata gjen se vendimi me nr. me nr. 8191 të dt. 06.04.2020 të Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat – Sektori i Inspektoratit, nuk mund të trajtohet si titull përmbarrues, pasi që i njëjti nuk përmban kushtet të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit, prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarrues, mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lëshuar urdhrin përmbarrimor, nuk i përmban tiparet e përmbarrueshmërisë, konform Nenit 36 par. 1 të LPP-së, pasi që nuk përmban klauzolën e përmbarrueshmërisë

Andaj, gjykata vlerëson se dokumenti përmbarrimor në bazë të cilit është lëshuar urdhri nga përmbarruesi privat, nuk i plotëson kushtet për përmbarrim që duhet t'i ketë dokumenti përmbarrimor, prandaj ka vendosur si në dispozitiv, duke shfuqizuar Urdhrin e lejuar nga Përmbarruesi Privat dhe ka përfunduar procedurën përmbarrimore në këtë çështje.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykate pranoi prapësimin e debitorit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.612/22, datë 07.11.2022

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.